



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
**AUTORITETI I KONKURENCËS**  
**DREJTORIA E ANALIZËS DHE METODOLOGJISË SË TREGJEVE**

**NJOFTIM**

**Rasti:** Përftimi i kontrollit të shoqërisë Studio Moderna Albania SHPK nga shoqëria SMA Holding SHPK.

Pranë Autoritetit të Konkurrencës është protokolluar shkresa nr. 12 datë 04.01.2024, “Mbi njoftimin e transaksionit të realizuar për transferimin e kuotave të shoqërisë Studio Moderna Albania SHPK tek SMA Holding SHPK”, ku jemi njoftuar në lidhje me transaksionin e propozuar mbi transferimin e 100% të kapitalit të Studio Moderna Albania SHPK tek shoqëria SMA Holding SHPK.

Palët në transaksion janë:

**Pala blerëse: SMA Holding SHPK** është një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar, e themeluar sipas legjislacionit shqiptar, me objekt aktiviteti: organizimi si një shoqëri holding; ofrimi i asistencës për shoqëritë në të cilat shoqëria holding është zotëruese e plotë ose e pjesshme e kuotave, aksioneve, dhe ose interesave në ato shoqëri në mënyrë të drejtpërdrejtë ose të tërthortë nga vetë shoqëria apo ortakët e saj; blerja në mënyrë të drejtpërdrejtë apo të tërthortë e interesave në shoqëri të tjera që kanë objekt aktiviteti të ngjashëm me atë të Shoqërisë, etj.

**Pala shitëse: Studio Moderna Holdings Investments B.V** është një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar, e themeluar sipas legjislacionit hollandez.

**Shoqëria Target: Studio Moderna Albania SHPK** është një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar, e themeluar sipas legjislacionit shqiptar, me objekt aktiviteti: teleshopping, import-eksport, tregti mallrash e shërbimesh, si dhe çdo lloj tjetër aktiviteti në përputhje me ligjin. Konkretisht, Studio Moderna Albania SHPK tregon marka si: Top Shop, Dormeo, Wellneo, Delimano, Walkmaxx, Rovus.

Nga shqyrtimi i dokumentacionit, rezulton se transaksioni i njoftuar është në përputhje me nenin 10 dhe 12 të ligjit, sipas të cilit duhet respektivisht të realizohet ndryshimi i qëndrueshëm i kontrollit, si dhe të plotësohen kriteret e xhiros.

Për sa më sipër, ky transaksion është objekt autorizimi nga Komisioni i Konkurrencës.

Autoriteti fton palët e interesuara, që brenda pesë ditëve nga shpallja e njoftimit, të shprehin opinionet e tyre për transaksionin e njoftuar.

**Opinionet mund të dërgohen pranë Autoritetit të Konkurrencës, me postë në adresën: Autoriteti i Konkurrencës, Rr. “Sami Frashëri”, Nr. 4, Kati IV Tiranë; apo me e-mail në adresën [competition@caa.gov.al](mailto:competition@caa.gov.al).**